

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Jelena Krivokapić, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve A.D., B.D., D.D., S.D., F.D., J.D., N.D., Z.D., S.S. dhe I.Th., për shkak të veprave penale krime të luftës nga neni 31 dhe 152 par.1 dhe 2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPK dhe në shkelje të nenit 4.par.2 (a) të Protokollit shtesë II (PSHII) dhe krime të luftës në vazhdim nga neni 81 par.1, neni 31, neni 152 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPK dhe në shkelje të nenit 4 par.2 (a) PSH II duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve I.Th., S.D., N.D., D.D., F.D., B.D., Z.D., A.D., J.D., S.S., dhe kërkesës së përbashkët të dënuarve F.D. dhe N.D., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.58/2014 të datës 27.05.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.456/2015 të datës 14.09.2016, në seancën e mbajtur më datën 26.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve I.Th., S.D., N.D., D.D., F.D., B.D., Z.D., A.D., J.D., S.S., dhe kërkesa e përbashkët e të dënuarve F.D. dhe N.D., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.58/2014 të datës 27.05.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.456/2015 të datës 14.09.2016.

A r s y e t i m

Aktgjykimi i shkallës së parë

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.58/2014 të datës 27.05.2015 janë shpallur fajtor të dënuarit: A.D., B.D., D.D., S.D., F.D., J. D., N.D., Z.D., S.S. dhe I.Th., për veprën penale krime të luftës nga neni 31 dhe 152 par.1 dhe 2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPK dhe në shkelje të nenit 4 par.2 (a) të Protokollit shtesë II (PSHII) dhe për këtë vepër penale i dënuari S.S., është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh, të dënuarit J. D., Z.D. dhe I.Th., me dënime me burgim në kohëzgjatje secili prej nga 6 (gjashtë)

vitesh ndërsa të dënuarit A.D., D.D., B.D., S.D., F. D., dhe N.D., me dënime me burgim secili në kohëzgjatje prej nga 3 (tre) vitesh.

Me të njëjtin aktgjykim të dënuarit J.D., Z.D., S.S. dhe I.Th., janë shpallur fajtor edhe për veprën penale krime të luftës në vazhdim nga neni 81 par.1, neni 31, neni 152 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPK dhe në shkelje të nenit 4 par.2 (a) PSH II dhe për këtë vepër penale janë dënuar me dënime burgimi, i dënuari S.S., në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh ndërsa të dënuarit J.D, Z.D. dhe I.Th., në kohëzgjatje secili prej nga 5 (pesë) vitesh.

Me aplikimin e dispozitave për veprat penale në bashkim, të dënuarit S.S., J.D., Z.D. dhe I.Th., janë dënuar me dënime unike me burgim, i dënuari S.S., në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh ndërsa të dënuarit J.D., Z.D., dhe I.Th., në kohëzgjatje secili prej nga 7 (shtatë) vitesh.

Periodha e privimit nga liria e Z.D. dhe J.D., nga data 23.05.2013 dhe I.Th., nga data 24.05.2013, përkatësisht deri në 31.05.2014, në arrest shtëpiak dhe nga data 32.05.2013 deri më 19.12.2014 në paraburgim, janë llogaritur në dënimet e shqiptuara. Është vendosur që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të dënuarit të paguajnë shumat si në vijim: i dënuari J.D., 1.000 euro, të dënuarit Z.D., S.S. dhe I.Th., nga 500 euro, të dënuarit tjerë nga 300 euro ndërsa shpenzimet e mbetura të procedurës penale të paguhen nga burimet buxhetore.

Aktgjykimi i shkallës së dytë

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.456/2015 të datës 14.09.2016, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorit të Shtetit si dhe ankesat e mbrojtësve të dënuarve por aktgjykimin e shkallës së parë pjesërisht e ka ndryshuar ashtu që sa i përket të dënuarve S. S., I.Th., Z.D. dhe J.D., veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor, juridikisht i ka cilësuar si vepër penale në vazhdim. Sa i përket këtyre të dënuarve, aktgjykimi i ankimuar është ndryshuar edhe përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që të dënuarit S.S., i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh, ndërsa të dënuarve I.Th., Z.D. dhe J.D., në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) vitesh. Aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar edhe përkitazi me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim gjegjësisht në arrestin shtëpiak, ashtu që janë precizuar datat e sakta të llogaritjes, si dhe në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës penale ashtu që është vendosur që këto shpenzime pjesërisht do të rimbursohen nga J.D., në shumën prej 500 euro. Në pjesët e mbetura, aktgjykimi është konfirmuar.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë

Duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë aktgjykimin PKL.nr.322/2016 të datës 19.07.2017 me të cilin janë refuzuar si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve I.Th., S.D., N.D., D.D., F.D., B.D., Z.D., A.D., J.D. dhe S.S. si dhe kërkesa e përbashkët e të dënuarve F.D. dhe N.D..

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Duke vendosur sipas kërkesave për vlerësimin e kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PKL.nr.322/2016 të datës 19.07.2017, të paraqitura nga mbrojtësit e të dënuarve I.Th., Z.D. dhe J.D., si dhe atyre të paraqitura nga të dënuarit F.D. dhe N.D., Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka marr aktgjykimin në rastet nr.KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17 të datës 07.06.2018. me të cilin i njëjti është shpallur i pavlefshëm dhe rasti është kthyer Gjykatës Supreme të Kosovës në rishqyrtim.

Sipas gjetjeve në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e drejta për një gjykim të drejt përfshinë të drejtën për një vendim të arsyetuar. Në rastin konkret, aktgjykimin të kundërshtuar i mungojnë arsyet e plota lidhur me përbërjen e trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë, konkretisht sa i përket përzgjedhjes së gjyqtarës Anna Adamska Gallant, e cila është një prej pretendimeve në disa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Me këtë rast, theksi i veçantë është në kualitetin e arsyeve të dhëna për aplikimin e dispozitave të Udhëzimit për përcaktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale në gjykatat e qarkut i cili është nxjerr në bazë të nenit 2.6 të Ligjit nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovës. Në përfundim të aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese është konstatuar se duke dështuar të japë një vlerësim dhe arsyetim të plotë lidhur me atë se a ka qenë caktimi i gjyqtarëve gjykues në rastin e parashtruesve në Gjykatën Themelore, në pajtim me tërësinë e dispozitave ligjore të zbatueshme, me aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës Supreme është shkelur e drejta e parashtruesve për një vendim të arsyetuar dhe me këtë është shkelur e drejta e parashtruesve për një gjykim të drejt dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

Sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesve, Gjykata Kushtetuese ka konsideruar se ato kryesisht ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë dhe se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetime të hollësishme për të gjitha këto çështje në aktgjykimin e saj.

Rishqyrtimi i çështjes nga Gjykata Supreme e Kosovës

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë

Çështja e shqyrtimit në këtë fazë-në rishqyrtim, janë kërkesat për mbrojtje e ligjshmërisë, të ushtruara kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë, nga:

- mbrojtësi i të dënuarit I.Th., avokati A.Q-Sh.A "S. & Q." sh.p.k., për shkak të shkeljes së Ligjit penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe i dënuari të shpallet i pafajshëm për veprat penale që i vihen në barë,

- mbrojtësi i të dënuarit S.D., avokati R.M, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të hedhet aktakuza e Prokurorisë Speciale të Kosovës ose që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje,

- mbrojtësi i të dënuarit N.D., avokati B.M, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza dhe të shtyhet ekzekutimi i aktgjyqimeve në fjalë,

- mbrojtësi i të dënuarit D.D., avokati K.O, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ose të ndryshohen ashtu që i dënuari të shpallet i pafajshëm për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor,

- mbrojtësi i të dënuarit F.D., avokati V.B., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje,

- mbrojtësi i të dënuarit B.D., avokati Sh.I., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim,

- mbrojtësi i të dënuarit Z.D., avokati B.T., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që paraburgimi ndaj të dënuarit të abrogohet dhe ai të lëshohet në liri, që Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të ftohet për të dëshmuar lidhur me mënyrën se si është formuar trupi gjykues në gjykatën e shkallës së parë, aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje,

- mbrojtësi i të dënuarit A.D., avokati I.A., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim,

- mbrojtësi i të dënuarit J.D., avokati M.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimeve të kundërshtuara dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të ndryshohen ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza ose të anulohen dhe çështja të kthehet aktgjykimin të shkallës së parë në rigjykim si dhe që ndaj tij të abrogohet paraburgimi,

- mbrojtësi i të dënuarit S.S., avokati G.d.G-S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal me propozim që të ndryshohet dënimi i tij ose të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje. Po ashtu ka propozuar që Gjykata Supreme të mbajë një seance në të cilin duhet të hetojë mënyrën e caktimit të gjyqtarës Anna Adamska Gallant në trupin gjykues të gjykatës së shkallës së parë, të sigurojë raportin e kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it lidhur me këtë, të dëgjojë si dëshmitar kryetarin e gjyqtarëve të EULEX-it Malcolm Simmons. Kërkesës ia ka bashkëngjitur një letër e të lartë emëruarit dhe disa emaila të nëpunësve të EULEX-it lidhur me shkeljet e pretenduara, dhe

- të dënuarit F.D. dhe N.D., kërkesë të përbashkët, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të ndryshohen ashtu që të lirohen nga akuza ose të anulohen dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe me propozim që Gjykata Supreme të mos të lejoj ekzekutimin e aktgjykimin përderisa të vendoset për kërkesën.

Pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit I.Th., avokatit A.Q-Sh.A “S. & Q.” sh.p.k. pretendohet se:

- në aktgjykimin e shkallës së dytë është përdorur termi “dëshmitari armiqësor” edhe pse një institut i tillë nuk ekziston në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe në këtë mënyrë është shkelur parimi i sigurisë juridike, në kundërshtim me nenin 6 të KDENJ;

- edhe pse nuk janë plotësuar kushtet ligjore, në shqyrtimin gjyqësor është lexuar raporti i ekspertit mjekësor dr. M.G., i cili nuk është ftuar në shqyrtim dhe palëve iu është pamundësuar që ekspertit ti bëjnë pyetje lidhur me raportin e tij, që paraqet shkelje të nenit 341 par.3 të KPPK;

- gjykatat kanë mare si të besueshme dëshminë e dëshmitarit A i cili ka bërë identifikimin e të dënuarit I.Th., dhe bazuar në këtë provë të vetme, të dënuarin e kanë shpallur fajtor. Përveç kësaj, kjo dëshmi nuk ka qenë provë e sigurt dhe bindëse, sepse dëshmitari A paraprakisht e ka identifikuar një person tjetër si kryes të veprës penale, e ka pa me fytyrë të ngjyrosur dhe në dritën e qirinjve. Gjykatat, për më tepër, nuk kanë respektuar rregullat të parapara me dispozitën e nenit 120 të KPPK dhe aktgjykimet e veta nuk kanë mundur të bazojnë në një provë të këtillë. Në anën tjetër, gjykata, pa angazhuar ekspert të psikiatrisë, duke e marrë rolin e ekspertit, vet e ka vlerësuar aftësinë e dëshmitarit A që të jep deklaratë të saktë;

- nuk ka ekzistuar lidhja e dëshmitarit B me konfliktin e armatosur. Në aktgjykim thuhet se ai është keqtrajtuar për shkak të bashkëpunimit të tij të pretenduar me regjimin serb, por provat e administruara nuk e lidhin këtë dëshmitar me konfliktin e armatosur;

- me rastin e shqiptimit të dënimit është shkelur ligji penal sepse gjykata nuk ka marrë parasysh kalimin e kohës së gjatë nga koha e kryerjes së pretenduar të veprës penale dhe procedurës së zhvilluar penale.

Mbrojtësi i të dënuarit S.D., avokatit R.M, në kërkesë ka pretendua se:

- aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 384 par.1 pika 8 të KPPK, sepse bazohen në deklaratën e dëshmitarit A, edhe pse ky dëshmitar ka qenë anonim dhe ka dhënë dëshmi kundërtënëse me vetveten dhe me provat tjera të nxjerra. Përveç kësaj, aktgjykimet janë të përfshira edhe me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse dispozitivët e tyre janë në kundërshtim me vet vetën dhe iu mungojnë arsyet për faktet vendimtare. Fakti vendimtar i cili është vërtetuar në mënyrë të gabuar ka qenë fakti se i dënuari S.D., ka qenë ushtar i UÇK, edhe pse provat, siç është certifikata 1/377 dhe kopja e listës së brigadës, e tregojnë të kundërtën. Për këtë arsye pretendohet se është bërë edhe shkelja e ligjit penal nga neni 385 pika 2 të KPPK.

Pretendimet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit N.D., avokatit B.M, janë:

- aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1 dhe 2 të KPPK për shkak të përbërjes jo të rregulle të trupit gjykues, sepse, në kundërshtim me ligjin, trupi gjykues ka qenë në përbërje vetëm të gjyqtarëve të EULEX-it;

- shkeljet tjera procedurale, tani nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK, manifestohen me shpalljen e të dënuarit fajtor, në bazë të vetëm një dëshmie të

dëshmitarit anonim-dëshmitarit A dhe me faktin se aktgjykimeve iu mungojnë arsyet për bashkëkryerjen në mes të dënuarit N.D., me të dënuarit tjerë, e për më tepër, dëshmitari A asnjëherë nuk ka deklaruar se i dënuari N.D., ka kryer ndonjë veprim inkriminues.

Mbrojtësi i të dënuarit D.D., avokatit K.O, aktgjykimet i ka kundërshtuar me këto pretendime:

- aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë përpiluar konform dispozitave nga neni 370 të KPPK, dispozitivet e tyre janë në kundërshtim më arsyet e dhëna, aktgjykimeve iu mungojnë arsyet për faktet vendimtare dhe të gjitha këto paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK;

- aktgjykimet bazohen në provë të papranueshme-në dëshmitë e dëshmitarëve A dhe K, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 8 të KPPK. Këto dëshmi janë kundërthënëse me vet vetën por edhe me provat tjera. Në kërkesë theksohen një nga një provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, siç janë raporti i ekspertit dr. G.H., regjistri i ushtarëve të UÇK, çertifikata e organizatave të veteranëve të luftës, por edhe provat tjera, të cilat tregojnë për një jokredibilitet të lartë të kësaj dëshmie. Kjo dëshmi është edhe e palogjikshme, sepse ai nuk ka kërkuar ndihëm mjekësore për pasojat e veprave penale që kinse janë kryer ndaj tij, ndërsa thënie e tij se organizatat vullnetare si Kryqi i Kuq dhe Mjekët e Nënës Terezë kanë qenë lidhura me UÇK, nuk janë të vërteta. Më tutje pretendohet se ky dëshmitar nuk është keqtrajtuar e as lënduar dhe e tërë deklarata e tij nuk ka mundur të jetë bazë për marrjen e aktgjykimit gjykues;

- në dëm të dënuarit është shkelur ligji penal sepse është shpallur fajtor për veprën penale edhe pse fajësia e tij në procedurën gjyqësore nuk është vërtetuar.

Pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit F.D., avokatit V.B., janë si në vijim:

- aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse nuk është gjykuar plotësisht esenca e aktakuzës, janë të pakuptueshme dhe kundërthënëse dhe përmbajtja e arsyeve të dhëna është në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës. Kundërthëniet posaçërisht manifestohen në atë se në paragrafin 80, gjykata e shkallës së parë iu referohet të gjithë të akuzuarve, por nuk precizon se cili prej tyre i ka rrahur dëshmitarët A dhe B, ndërsa dëshmitari B asnjëherë nuk ka thënë se e ka rrahur i dënuari F.D.; në paragrafin 60.gjykata e shkallës së parë thekson se F.D., ka pësuar një lëndim në krah i cili është shkaktuar me granatë të dorës, i është

rekomanduar që krahun e plagosur të mos te përdori për 3 muaj, por janë përdorur termet “plagë” dhe “lëndim” të cilat nuk e kanë kuptimin e njëjtë;

- në kundërshtim me nenin 262 të KPPK, i dënuari është shpallur fajtor duke u bazuar ekskluzivisht ose në masë vendimtare, në dëshminë e dëshmitarit A dhe në këtë mënyrë është shkelur edhe parimi “in dubio pro reo”;

- trupi gjykues i gjykatës së shkallës së parë ka qenë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, sepse ka qenë në përbërje nga tre gjyqtar të EULEX-it, më vend që njëri prej anëtarëve të ishte gjyqtar vendor, e në anën tjetër, dhe njëri prej anëtarëve është emëruar në kundërshtim me rregullat e brendshme të EULEX-it, sepse sipas tyre, vetëm gjyqtarët e EULEX-it që shërbejnë në Gjykatën Themelore në Prishtinë mund të ishin emëruar si gjyqtarë zëvendësues në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Edhe mbrojtësi i të dënuarit B.D., avokatit Sh.I. pretendon se:

- aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të ligjit penal, sepse i dënuari është shpallur fajtor për veprime të cilat nuk i ka kryer, gjegjësisht të cilat nuk janë vërtetuar nga provat e administruara;

- shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale manifestohen në faktin se përkundër gjetjes së ekspertit dr. G.H. se dëshmitari A vuan nga sëmurje psikike, gjykatat kanë gjetur se deklarata e tij është e besueshme, duke e marrë rolin e ekspertit, që është në kundërshtim me dispozitat procedurale në fjalë.

Pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit Z. D., avokatit B.T., janë si në vijim:

- dispozitivi i aktgjyimit i shkallës së parë është i pakuptueshëm sepse nuk specifikon kohën e kryerjes së veprave penale e as veprimet konkrete të secilit të akuzuar, ndërsa përmban shume informacione të panevojshme;

- në procedurën ankimore, gjykata e shkallës së dytë jo vetëm se nuk ka mënjeluar këtë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, por ka marrë aktgjykimin me të cilin nuk janë trajtuar e arsyetuar pretendimet ankimore në lidhje me ndarjen e procedurës në dy raste të veçanta, caktimin e gjyqtarës Anna Adamska Gallant në trupin gjykues të shkallës së parë, konceptin e dëshmitarit armiqësor dhe për bazën e fajësisë së të dënuarit, si dhe për shkeljen e rregullave të brendshme për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it ashtu që përbërja jo ligjore e trupit gjykues ka ndikuar drejt për së drejti në rezultatin e vendimmarrjes;

- shkelja tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 10 të KPPK ka të bëjë me tejkalimin e aktakuzës, e cila nuk është eliminuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata ankimore;

- gjykata e shkallës së parë vendimin për fajësinë e të dënuarit Z.D., e ka bazuar ekskluzivisht në dëshminë e dëshmitarit A. Dëshmitarin B e ka shpallur “dëshmitar armiqësor” dhe dëshminë e tij e ka trajtuar si dëshmi jo të besueshme, ndërsa dëshminë e dëshmitarit K si dëshmi rrethore dhe duke vepruar kështu ka bërë shkelje të praktikës gjyqësore të Kosovës dhe GJEDNJ sipas të cilave aktgjykimi mund të bazohet vetëm në prova të drejtpërdrejta, e jo në prova rrethore;

- vetëm dëshmia e dëshmitarit A nuk ka mjaftuar për të vërtetuar fajësinë e të dënuarit. Dëshmitë e tij të dhëna në vitet 2008 dhe 2011, nuk i janë dorëzuar mbrojtjes që nuk e përjashton mundësinë se dëshmitari është udhëzuar se si të dëshmojë. Dëshmia e dëshmitarit ka qenë me shumë kontradita, jo reale dhe në kundërshtim me provat tjera, siç janë dëshmia e dëshmitarit B, dëshmitarit K dhe provat tjera dhe këto mangësi nuk mund të arsyetohen me kalimin e kohës nga ngjarja kritike;

- elementi qenjësor i torturës në kuadër të krimit të luftës është shkaktimi i dhimbjes dhe vuajtjes ndaj popullsisë civile, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me dy raste të izoluar dhe nuk është vërtetuar se i dënuari i ka kryer e as që ka qenë në dijeni të fakteve të cilat e përbëjnë veprën penale.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.D., avokatit I.A., pretendohet se:

- me aktgjykimet e kundërshtuara është bërë shkelje e ligjit penal në dëm të dënuarit, pasi që nuk është vërtetuar se ka ndërmarr veprimet inkriminuese;

- deklarata e dëshmitarit A nuk ka qenë e besueshme sepse nga konstatimi i ekspertit dr.G.H., është vërtetuar se ai vuan nga një sëmurje psikologjike, e përkundër kësaj, gjykatat kanë gjetur të kundërtën, duke e marrë rolin e ekspertit dhe, në këtë mënyrë, kanë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit J.D., avokatit M.S., theksohet se:

- aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse përbërja e trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë ka qenë në kundërshtim me ligjin. Trupi gjykues ka qenë i përbërë vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it dhe është e parëndësishme se ka ekzistuar marrëveshja në

mes të shefeve të EULEX-it dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për përbërje të këtillë në gjykatën e Mitrovicës, sepse marrëveshja nuk është ligj. Lidhur me këtë, është e qartë se Gjykata Themelore në Mitrovicë duke vendosur në rastin konkret, ka qenë në dijeni për këtë, sepse i është referuar “praktikës së krijuar” por jo ligjit;

- Gjykata e Apelit nuk ka dhënë arsyetim ligjor për pretendimet ankimore lidhur me përbërjen e trupit gjykues, duke dhënë arsyetim konfuz edhe për pretendimin për përzgjedhjen e kundërligjshme të një anëtari të trupit gjykues nga gjyqtarët të EULEX-it.

- aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm, i mungon përshkrimi i qartë të veprimeve konkrete inkriminuese për secilin të akuzuar, përcaktimi i periudhave kohore në të cilat janë ndërmarrë veprimet e pretenduara inkriminuese dhe pasojat e shkaktuara. Ka kundërshtim edhe në atë pikëpamje se dispozitivi i referohet Kodit Penal të Kosovës të vitit 2004, ndërsa arsyetimi, Kodit Penal të Kosovës të vitit 2013;

- edhe dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së dytë është i pakuptueshëm sepse në të ceket se ankesat janë refuzuar ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar. Arsyetimi i tij është kundërthënës sepse edhe pse në dispozitiv nuk ceket se J.D. e ka urdhëruar dëshmitarin A dhe dëshmitarin B që të rrahin njëri tjetrin, ose që ai e ka rrahur dëshmitarin A me shkop të drurit, por këto ceket në dispozitiv dhe karakterizohen si veprime inkriminuese;

- shkelje tjetër esenciale e dispozitave të procedurës penale është ajo nga neni 384 par.1 pika 10 të KPPK sepse përshkrimi faktik i veprimeve të dënuarit ndryshon thelbësisht nga ai i dhënë në aktakuzë;

- deklaratat e dëshmitarëve A dhe B janë marrë në kundërshtim me dispozitat e KPPK sepse ato nuk i janë dhënë mbrojtjes. Disa dëshmitar janë shpallur “dëshmitar armiqësor”, që në KPPK nuk ekziston. Prokurorit i është lejuar që dëshmitarëve ti parashtrijë pyetje drejti për së drejti dhe kryetari i trupit gjykues disa herë i ka ndihmuar në formulimin e pyetjeve, duke e shkelur barazinë në mes palëve;

- aktgjykimet e kundërshtuara janë kundërthënëse edhe për faktin se në ato konstatohet se dëshmitë e dëshmitarëve A dhe K përmbajnë mangësi por aktgjykimi fajësues bazohet në këto dëshmi. Për më tepër, këto dëshmi nuk janë në përputhje me provat tjera të administruara, por për këtë mungon arsyetimi;

- duke vendosur për dënimin, gjykata e shkallës së parë ka aplikuar ligjin i cili nuk ka qenë fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale ndërsa gjykata e shkallës së dytë lidhur me pretendimin ankimor për shkeljen e ligjit penal, ka dhënë arsye të pakuptueshme në ç 'mënyrë, me aplikimin e dispozitave ligjore të cilat nuk kanë qenë në fuqi në kohën kritike, është shkelur parimi i ligjshmërisë dhe praktika gjyqësore e Kosovës dhe është bërë shkelje e ligjit penal;

- me rastin e vendosjes për dënim, përshkrimi faktik i veprës penale është konsideruar si rrethanë rënduese që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse arsyetimi i këtillë është i paqartë dhe i paqëndrueshëm e njëkohësisht, nuk janë vlerësuar një mori të rrethane lehtësuese në anën e të dënuarit.

Pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit S.S., avokatit G.d.G-S., janë si në vijim:

- pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë, në transmetimin televiziv të "Koha vizionit" është raportuar se para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kryetari i trupit gjykues Dariusz Sielicki ka thirr me telefon ushtruesin e detyrës të kryetarit të gjyqtarëve të EULUX-it Gerrit Sprenger e pastaj i ka dërguar email në të cilin ka kërkuar që si anëtar i trupit gjykues të caktohet një gjyqtar nga ekipi mobil. Pastaj është hartuar një urdhër për të caktuar në këtë cilësi gjyqtarja Anna Adamska Gallant, e cila ka qenë në ekipin mobil, por jo gjyqtarja me radhë. Në kundërshtim me këtë listë, ajo është zgjedhur nga gjyqtari Dariusz Sielicki, sepse ajo ka qenë e dashura e tij, i cili ka pasur qëllimin që ajo të avancohet në karrierën e saj, bazuar në atë se ka gjykuar krim të luftës dhe kjo edhe ka ndodhur sepse gjyqtarja pastaj është emëruar në gjykatën më të lartë. E tërë kjo ka ndodhur në kundërshtim me procedurat, politikat dhe rregullat e përzgjedhjes së trupave gjykues të gjyqtarëve të EULEX-it. Pasi që për këtë parregullsi mbrojtja nuk ka qenë në dijeni por kjo është kuptuar pas shpalljes së aktgjykimit, nuk ka bërë vërejtje në përbërjen e trupin gjykues, por e ka cekur në ankesë, pasi që paraprakisht e ka njoftuar kryetarin e gjyqtarëve të EULEX-it. Malcolm Simmons. Megjithatë, Gjukata e Apelit nuk ka dhënë arsye ligjore për këto pretendime por si arsyetim vetëm ka cekur se nuk ka pasur listë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it, në vitin 2013 dhe se caktimi i gjyqtarës si anëtare të trupit gjykues nuk ka qenë në kundërshtim me rregullat. Nga emailat e shumta anonime të nëpunësve të EULEX-it, mbrojtja ka kuptuar se kryetari i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së dytë ka qenë i pakënaqur me këtë situatë dhe ka përpiluar një raport duke i shprehur shqetësimet e tij në lidhje me paanshmërinë e trupit gjykues. Në fund, lidhur me këtë pretendim, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë theksohet se vetëm 5 minuta pas marrjes së kërkesës me email nga gjyqtari Dariusz Sielicki për caktimin e anëtarit të trupit gjykues, ushtruesi i detyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it ka kërkuar nga

nëpunësi që të përpilon vendimin për caktimin e gjyqtares Anna Adamska Gallant nga lista mobile, që do të thotë se nuk ka pas kohë që të kontrollojë këtë listë;

- edhe pse sipas nenit 315 të KPPK rrjedhja e shqyrtimit gjyqësor regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike, përveç nëse ka shkaqe të arsyeshme për mos regjistrime të këtilla, në rastin konkret, kryetari i trupit gjykues ka refuzuar propozim e mbrojtësit që të mbahet procesverbali i fjalëpërfjalshëm i shqyrtimit duke vendosur që të mbështetet në diktim daktilografit duke e monitoruar vet procesverbalin në ekranin e kompjuterit. Në këtë mënyrë është pamundësuar të kontrollohet saktësia e procesverbalit dhe kjo ka qenë shkelje e etikës së gjyqtarit dhe ka cenuar besimin në integritetin e gjyqësorit. Ka pas dallime në mes të asaj se çka ka deklaruar dëshmitari në gjuhën shqipe dhe asaj që është përkthyer në gjuhën angleze. Pretendimet tjera shpjegojnë se kjo ka pamundësuar edhe gjykatën e shkallës së dytë që të kuptojë fjalë për fjalë procesin e shqyrtimit gjyqësor dhe të nxjerr përfundime të sakta për pretendimet ankimore dhe gjetjet e saj për jo bazueshmërinë e ankesës nuk kanë qenë të drejta;

- nga të ashtuquajtur “dëshmitarët armiqësor” është kërkuar që t'i nënshkruajnë deklaratat të cilat nuk janë përkthyer në gjuhën e tyre dhe nuk iu janë lexuar në gjuhën e tyre. Ato nuk i janë dërguar palëve, kanë qenë të pasakta dhe në procedurën e mëvonshme kanë pësuar ndryshime. Përkundër kësaj, këtyre deklaratave iu është kushtuar besim dhe kështu të akuzuarve iu është mohuar e drejta në gjykim të drejt, shkelje këto të cilat nuk janë mënjanuar as me aktgjykimin e shkallës së dytë;

- me aktgjykimin e shkallës së dytë nuk janë vlerësuar me saktësi pretendimet ankimore dhe nuk është zbatuar standardi i duhur ligjor ashtu që edhe ky aktgjykim ka të meta të shumta procedurale; kjo gjykatë nuk e trajtuar e as vlerësuar drejt deklaratën e dr. C.B., duke konkluduar gabimisht se deklarata e dëshmitari A nuk është mbështetur nga kjo deklaratë. Kredibiliteti i dëshmisë së dëshmitarit A ka qenë tejet i dyshimtë në lidhje me lëndimet trupore që i ka pësuar, por gjykatat nuk e kanë aplikuar parimin *in dubio pro reo*. Edhe në këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë janë theksuar pretendimet lidhur me mos vlerësimin e ekspertizës së dr. G.H., lidhur me gjendjen mendore e dëshmitarit A dhe marrjen e rolit të ekspertit nga ana e gjykatës, të cilat nuk janë eliminuar me aktgjykimin e shkallës së dytë. Në këtë mënyrë, pa vërtetuar/testuar gjendjen mendore të dëshmitari A, i cili e ka identifikuar të dënuarin S.S. si kryes të veprës penale, ky identifikim nuk ka qenë i besueshëm, shkelje kjo e cila nuk është trajtuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Në kërkesën e përbashkët të dënuarve F.D. dhe N.D., pretendohet se:

- të dënuarve iu është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të zhvilluar brenda një kohë të arsyeshme, sepse kanë kaluar mbi një vit e pesë muaj nga shpallja e aktgjykimit të shkallës së parë deri në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së dytë,

- parimi i supozimit të pafajësisë së të dënuarve, nuk është respektuar as në fillimin e procedurës penale, ndërsa gjatë rrjedhjes së procedurës është konstatuar se gjykatat iu kanë fal besimin vetëm provave që e mbështesin aktakuzën. Dëshmia e dëshmitarit A është konsideruar e besueshme edhe pse ka qenë e rrejshme, e pambështetur me provat tjera. Vetëm pjesët e përzgjedhura të dëshmive tjera-të “dëshmitarëve armiqësor” janë konsideruar reale, ato që e mbështesin akuzën, ndërsa pjesët tjera janë konsideruar si të pabesueshme,

- marrja në pyetje e dëshmitarëve është bërë në mënyrë të kundërligjshme, atyre iu janë bërë kërcënime dhe premtime, në mënyrë që të ndikohet në deklaratimet e tyre, prokurorit iu është lejuar që vazhdimisht t`ju bëjë pyetje sugjестive dhe disa prej tyre janë shpallur “dëshmitar armiqësor”, çka as si term nuk ekziston në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Me të gjitha këto si dhe me faktin se kryetari i trupit gjykues i ka ndihmuar prokurorit në formulimin e pyetjeve, është shkelur parimi i barazisë së palëve,

- edhe në këtë kërkesë janë paraqitur pretendimet për përbërjen jo ligjore të trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë, për shkak të pjesëmarrjes të vetëm të gjyqtarëve të EULEX-it por edhe për atë se njëri prej anëtarëve të trupit gjykues është emëruar në mënyrë të paligjshme, që është kuptuar pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, e që tregon për paragjykimet e gjykatës së shkallës së parë;

- në dëme të dënuarve është shkelur ligji penal sepse është aplikuar ligji i cili, duke marrë parasysh kohën inkriminuese, ka qenë i disfavorshëm për ata.

Përgjigja e Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit, me parashtresat KMLP.II.nr.242/16 të datave 27.12.2016 dhe 20.01.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në të cilat ka propozuar që kërkesat të cilat janë ushtruar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ose pjesët e tyre që janë ushtruar për këtë bazë ligjore, të hedhen ndërsa të tjerat të refuzohen si të pabazuara.

Pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë në pjesën që kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, nuk mund të aprovohen, sepse për këtë bazë ligjore në bazë të nenit 432 par.2 të KPPK, kërkesa nuk mund të

parashtrohet. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i qartë, përmban elementet qenjësore të veprave penale për të cilat të dënuarit janë shpallur fajtor (mungesa a datës së saktë e kryerjes së veprës penale nuk e bënë të pakuptueshëm, ndërsa ajo mund të kryhet edhe kundër popullit të cili i përkasin të dënuarit).

Termi “dëshmitar armiqësor” nuk ekziston në KPPK, por përdorimi i tij nuk i bënë aktgjykimet të mangëta, sepse qartazi bëhet fjalë për dëshmitarët të cilit kanë devijuar nga deklaratat e mëparshme dhe të cilit janë konfrontuar me ato deklaratat. Mbrojtja ka pasur mundësi që të marrë në pyetje në mënyrë të tërthortë dëshmitarin A dhe këtë e ka bërë fuqimisht, ky dëshmitar ka qenë i njohur për mbrojtjen dhe nuk është shpallur dëshmitar i mbrojtur. Aktgjykimet e kundërshtuara kanë arsye të detaizuara për përmbajtjen e kësaj dëshmie dhe vlerësimin lidhur me provat tjera të administruara. Andaj, janë të pabazuara të gjitha pretendimet e ushtruara në këtë drejtim.

Trupi gjykues i gjykatës së shkallës së parë ka qenë në harmoni me ligjin. Përbërja e saj nuk është kundërshtuar nga palët sepse askush nuk ka pasur arsye për të dyshuar në paanshmërinë e trupit gjykues. Të dënuarve iu është siguruar respektimi i të drejtës për një gjykim të drejt nga gjyqtarët e paanshëm. Te emailat që ceken një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, dërguesit nuk janë staf i EULEX-it, nuk janë autentik, të saktë e as të besueshëm, kanë të bëjnë me thashetheme dhe adresat e postës elektronike nuk i përkasin EULEX-it. Sa i përket pretendimit se janë anashkaluar gjyqtarët tjerë dhe si anëtare e trupit gjykues është përzgjedhur gjyqtarja Anna Adamska Gallant, për këtë nuk ka prova dhe në aktgjykimin e shkallës së dytë është sqaruar se në vitin 2013. Nuk ka ekzistuar listë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it. Në anën tjetër, propozimet që të mbahet seancë për të hetuar nëse trupi gjykues ka qenë në përbërje të rregullt nuk është i bazuar sepse Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nuk e parasheh këtë mundësi.

Mungesa e procesverbalit të fjalëpërfjalshëm nuk paraqet arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Për më tepër, nëse kjo mungesë ka ndikuar në ndonjë parregullsi të procedurës, parashtruesi i kërkesës do të duhej të precizonte se për çka konkretisht bëhet fjalë.

Në parashtrësën e Prokurorit arsyetohen se as pretendimet tjera sa i përket përbërjes së trupit gjykues ekskluzivisht nga gjyqtarët e EULEX-it, ekspertizën e gjendjes mendore të dëshmitarit e as pretendimet tjera, nuk janë të bazuara dhe propozohet të merret vendim për refuzimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1, lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesat nuk janë të bazuara.

Gjetjet e gjykatës

1. Për pretendimet lidhur me përbërjen e trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me një anëtar të tij

Një prej pretendimeve në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit S.S. por edhe në disa kërkesa tjera të cilat më lartë u përshkruan, është se trupi gjykues në gjykatën e shkallës së parë është caktuar në kundërshtim me rregullat e caktimit të gjyqtarëve të EULEX-it Konkretisht, pretendohet se gjyqtarja Anna Adamska Gallant është caktuar si anëtare e trupit gjykues në kundërshtim me dispozitën e nenit 2.6 të Ligjit nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (më tutje “Ligji”) dhe me Udhëzimin për caktimin e lëndëve penale gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatat e qarkut (më tutje “Udhëzimi), i cili është nxjerrë në bazë dispozitës së lartpërmendur të Ligjit.

Me rastin e vlerësimit të këtij pretendimi, Gjykata Supreme konstaton se përmbajtja e dispozitës së nenit 2.6 të “Ligjit” është si në vijim:

“Pas konsultimit me Shefin e Komponentin e Drejtësisë, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do t`ia propozojë Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it përkatësisht Asamblesë së prokurorëve të EULEX-it, modalitetet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve në bazë të kriterëve objektive dhe masat siguroese procedurale të cilat do të jenë në përputhje me ligjin në fuqi. Këto modalitete që do të miratohen nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe Asambleja e Prokurorëve të EULEX-it, do të sigurojnë respektimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të EULEX-it si dhe të autonomisë së prokurorëve të EULEX-it në ushtrimin e funksioneve të tyre.”

Përmbajtja e dispozitave të “Udhëzimit” (që ndërlidhet me vendosjen në rastin konkret) është si në vijim:

Neni 3.1 “Brenda sesionit rastet do t`u ndahen gjyqtarëve sipas sistemit numerik ku çdo rast i tretë që vjen në seksion do të ndahet për gjyqtarin A, secili rast i tretë për gjyqtarin B dhe çdo rast i tretë për gjyqtarin C (nr.1 për gjyqtarin A, nr.2 për gjyqtarin B, nr.3 për gjyqtarin C, nr.4 për gjyqtarin A dhe kështu me radhë). Për arsye të jashtëzakonshme (për shembull cilësinë dhe kompleksitetin e rastit dhe numrin e rasteve të besuara për secilin gjyqtar), gjyqtari caktues mund të ndaj rastet e zgjedhura në një mënyrë tjetër nga sa është përmendur më parë”.

Neni 5.3 : Gjyqtarët e EULEX-it vendosen në Gjykatën Supreme ose në një ose më shumë Gjykata të Qarkut. Vendosja e gjyqtarëve të EULEX-it në më shumë se një gjykatë të Qarkut do t'i përgjigjet nevojës për zëvendësim në raste të jashtëzakonshme. Në këto raste, gjyqtari i EULEX-it do të ketë vendin kryesor të tij në një Gjykatë të Qarkut dhe do të veprojë si zëvendësues i natyrshëm i një gjyqtari tjetër të EULEX-it në një Gjykatë tjetër të Qarkut.

Neni 5.5 : Një sistem i kujdestarisë/detyrës do të vendoset për situata emergjente në mes të gjykatave të lidhura më lartë në mënyrë që të sigurohet që një gjyqtar është në disproporcion për situata emergjente. Afati i caktimit në sistemin e kujdestarisë/detyrës caktohet për një javë duke përfshirë edhe fundjavat. Propozimi i sistemit të rotacionit dërgohet nga Kryetarët e Seksioneve të Krimeve të Luftës të gjyqtarëve përkatëse të qarkut tek Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it jo më pak se një muaj më parë.

Në çka bazohet ky pretendim?

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë theksohet se përbërja e trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë nuk ka qenë në përputhje me "Ligjin", se mbrojtja nuk ka bërë vërejtje në përbërjen e trupit gjykues, sepse nuk ka qenë në dijeni për parregullsinë, por për këtë është njoftuar pas shpalljes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe e ka cekur në ankesë.

Në këtë vend do të përsëriten thëniet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit S.S. se deri të informatat për mënyrën e kundërligjshme të caktimit të gjyqtarës Anna Adamska Gallant, ka ardhur nga mjetet e informimit. Më datën 24.06.2015 transmetuesi televiziv "Koha Vision" ka raportuar se kryetari i trupit gjykues Dariusz Sielicki e ka thirrur me telefon ushtruesin e detyrës të Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it Gerrit Sprenger-in e pastaj i ka dërguar email me kërkesë që një anëtar i trupit gjykues të caktohet nga ekipi mobil i EULEX-it. Ky i fundit ka kërkuar që të hartohet një urdhër që si anëtare e trupit gjykues të caktohet gjyqtarja Anna Adamsa Gallant edhe pse ajo nuk ka qenë gjyqtare e radhës në listën e ekipit mobil. E tërë kjo ka ndodhur për arsye se gjyqtari Dariusz Sielicki ka dëshiruar që gjyqtarja Anna Adamska Gallant, me të cilën ka qenë në marrëdhënie dashurie, të angazhohet në këtë çështje të krimit të luftës, me qëllim të avancohet në detyrë,

Se këto thënie janë të vërteta, sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, del edhe nga emailat për këtë kontakt në mes të dy të emëruarve, të cilat i janë bashkëngjitur kërkesës (dhe emailat tjera), të cilat parashtuesi i kërkesës i ka sigurua nga nëpunësit anonim të EULEX-it.

Duke e vlerësuar këtë pjesë të pretendimit, Gjykata Supreme konstatojë se burimet në të cilat thirret paraqitësi i kërkesës janë të pasigurta sepse bëhet fjalë për informata të marra nga mjetet e informimit dhe emailat anonime, të dërguara në kopje, ndërsa gjykata e bazon vendimin e vetë në prova që janë nxjerr sipas rregullave të ligjit procedural, të cilat janë të besueshme dhe të përshtatshme për vërtetimin e një fakti relevant, të vlerësuara edhe në lidhje me

provat tjera, siç kërkohet me dispozitën e nenit 361 par.2 të KPPK. Për më tepër, ky pretendim ndërlidhet me vërtetimin e fakteve (konkretisht të faktit se a ka pas veprime jo ligjore në përcaktimin e anëtarit të trupit gjykues), vlerësimi i të cilave, konform dispozitës së nenit 432 par.2 të KPPK, nuk mund të ngritët me këtë mjetë të jashtëzakonshëm juridik.

Megjithatë, kjo gjykatë i shikoje kopjet e emailave të bashkëngjitur.

Emaili i datës 29.05.2014, i dërguar në ora 11:37 nga Dariusz Sielicki për Katja Dominik, ka këtë përmbajtje:

“E nderuar Katja,

Në lidhje me përgatitjet për gjykimin e rastit Drenica 2 (9 të pandehur) me mirësi kërkohet nga ju që të merrni në konsideratë që të kërkoni nga kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it që të caktojë një gjyqtar nga ekipi mobil që të jetë anëtar i trupit gjykues.

Gjyqtarët e ekipit të Mitrovicës janë o të diskualifikuar për shkak të përfshirjes së tyre të mëparshme në rast, o vazhdimi i kontratave të tyre ende nuk është i qartë, ose qëndrimi i tyre në mision është shumë i shkurtër që të konsiderohen si me përvojë të mjaftueshme.....”

Emaili i datës 29.05.2014, i dërguar në ora 11:45 nga Katja Dominik për Gerrit-Marc Sprenger dhe CC Dariusz Sielicki, të cilit i është bashkëngjitur emaili i parë, ka këtë përmbajtje:

“I nderuar Gerrit,

Pajtohem me kërkesën e kryetarit të trupit gjykues në rastin e lartpërmendur dhe kërkohet nga ju që të caktoni në këtë rast një gjyqtar nga ekipi mobil për arsye të mëposhtme”.

Emaili i datës 29.05.2014, i dërguar në ora 11:50 nga Gerrit-Marc Sprenger për A.I., ka këtë përmbajtje:

“I nderuar A.,

Të lutem përpilo një vendim për caktimin në rast të gjyqtares Anna Adamska nga Ekipi Mobil.

Vendimi na nevojitet sa më parë të jetë e mundur.”

Nga ky komunikim dhe emaila tjerë të bashkëngjitur u nxjerrën këto përfundime:

- nuk ka prova për marrëdhëniet e dashurisë në mes të dy gjyqtareve, por mbrojtja thirret në thashetheme,

- në gjykatën e shkallës së parë nuk ka pas gjyqtar të mjaftueshëm për anëtarin e dytë të trupit gjykues dhe ka pas nevojë për caktimin e një gjyqtari nga lista mobile dhe

- gjyqtari Dariusz Sielicki nuk e ka propozuar gjyqtaren Anna Adamska Gallant për anëtare të trupit gjykues.

Andaj, pretendimi se propozimi i këtyre është bërë, nuk ka mbështetje. Në anën tjetër, nuk kishte mbështetje as pretendimi se qëllimi i propozimit dhe i caktimit të gjyqtarëve (*po të kishin ekzistuar*) ka qenë i motivuar me dëshirën që ajo të ngritet në detyrë, që ndërlidhet me marrëdhëniet e pretenduara të dashurisë, nuk janë bazë për përjashtimin e saj për shkaqet në vijim. Në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 39 të KPPK, taksativisht ceken bazat konkrete për përjashtimin e gjyqtarit nga ushtrimi i funksionit gjyqësor, e që janë marrëdhëniet farefisnore dhe marrëdhëniet tjera me pjesëmarrësit tjerë në procedurë, pjesëmarrja në vendimmarrje në çështjen e cila shqyrtohet me mjetin juridik, konflikti i interesit etj., ndërsa në paragrafin 3 ceket se :”gjyqtari gjithashtu *mund* të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rast konkret, nëse përpos rasteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, *prezantohen dhe vërtetohen* rrethana që e vënë në dyshim paanshmërinë e tij ose që duken të papërshtatshme”. Gjykata Supreme konkludon se përveç se marrëdhëniet e dashurisë në mes të emëruarave janë spekulime, as sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk del se kryetari i trupit gjykues ka pas për qëllim që të ndikojë në anëtarin e trupit gjykues me rastin e vendimmarrjes (p.sh. t`i sugjerojë se si të votojë) e që kishte për të ndikuar në paanshmërinë e saj dhe rrjedhimisht, të vihet në pyetje parimi i gjyqimit të drejtë, të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ.

Çështja e dytë ishte caktimi i gjyqtarëve-anëtarit të trupit gjykues, nga lista mobile, me shkelje të dispozitave të Udhëzimit.

Sipas pretendimeve në kërkesë, për këtë tregon edhe ngutja e Ushtruesit të Detyrës të Kryetarit të Gjyqtarëve Gerrit-Marc Sprenger i cili ka urdhëruara përpilimin e vendimit vetëm 5 minuta pasi e ka pranuar kërkesën. Mirëpo, Gjykata Supreme konstatojë se nga shkresat e lëndës del se vendimi-urdhri është marrë me datën 29.05.2014, ndërsa shqyrtimi gjyqësor ka filluar më datën 27.06.2014, pra pas afër një muaji, që nuk tregon për ndonjë veprim të ngutshëm në caktimin e anëtarit të dytë të trupit gjykues.

Më tutje, kjo gjykatë konstatojë se, siç u theksua më lartë, sipas nenit 3.1 të Udhëzimit, “brenda sesionit rastet do t`u ndahen gjyqtarëve sipas sistemit numerik ku çdo rast i tretë që vjen në seksion do të ndahet për gjyqtarin A, secili rast i tretë për gjyqtarin B dhe çdo rast i tretë për gjyqtarin C (nr.1. për gjyqtarin A, nr.2. për gjyqtarin B, nr.3. për gjyqtarin C, nr.4. për gjyqtarin A dhe kështu me radhë). Për arsye të jashtëzakonshme (për shembull cilësinë dhe kompleksitetin e rastit dhe numrin e rasteve të besuara për secilin gjyqtar), gjyqtari caktues mund të ndaj rastet e zgjedhura në një mënyrë tjetër nga sa është përmendur më parë”.

Kjo dispozite fletë për një ndarje-caktim të rastit në situata të zakonshme-fjalë e parë, dhe në situata të jashtëzakonshme-fjalë e dytë.

Lidhur me atë se kush është gjyqtari A,B,C dhe kështu me radhë, pra gjyqtari të cilit i është ndarë lënda, Gjykata Supreme e shikojë edhe nenin 3.2 të Udhëzimit, sipas së cilit “gjyqtari të cilit i është ndarë lënda është i përgjegjshëm për përgatitjen e duhur të lëndës dhe për përpilimin e aktgjykimit dhe vendimeve tjera në lëndë” dhe nenin 3.3 sipas së cilit “Kryetari i Seksionit është kryetar i trupit gjykues”.

Gjykata Supreme i shikojë edhe dispozitat tjera të Udhëzimit për të vërtetuar se sipas tij, si bëhet kompozimi i trupit gjykues. Me këtë rast konstatojë se sipas nenit 2.5 të Udhëzimit, “Gjyqtarët që janë në atë seksion do të jenë gjyqtarët (anëtarët) e trupit gjykues ...”.

Në rastin konkret, kryetari i trupit gjykues dhe gjyqtari i cili për detyrë ka pas përgatitjen e lëndës dhe përpilimin e vendimeve, ka qenë gjyqtari Dariusz Sielicki, si kryetar i trupit gjykues dhe në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk vihet në dyshim respektimi i këtij sistemi numerik në ndarjen e lëndës këtij gjyqtari. Sa i përket gjyqtarëve tjerë të seksionit, përzgjedhja e njërit anëtar po ashtu nuk kontestohet në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë (ajo e gjyqtarit Vidar Stensland) por përzgjedhja e anëtarit të dytë-gjyqtares Anna Adamska Gallant, nga lista mobile. Kur është fjala për përzgjidhen e saj nga lista mobile, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk kontestohet se ajo ka qenë në këtë listë, por kontestohet se ka qenë gjyqtare e radhës. Ky pretendim sërish ka të bëjë me spekulime, është i pambështetur dhe për shkaqet të cilat u cekën edhe më lartë, nuk u aprovua.

Gjykata Supreme, si përfundim, gjeti se aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.1 dhe 1.2 të KPPK të cilat në kërkesat pretendohen.

Këto ishin gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me këtë pretendim, me ç'rast u murrën në konsideratë të gjitha vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të dhëna në vendimin me të cilin aktgjykimi i mëparshëm ishte shpallur i pavlefshëm.

2. Për pretendimet tjera

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësojë edhe pretendimet tjera të paraqitura në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilat janë vlerësuar edhe në vendimin e mëparshëm të kësaj gjykate Pml.Kzz.nr.322/2016 të datës 19.07.2017 dhe për të cilat janë dhënë arsyet, të cilat Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk i ka prekur në vendimin e vet.

Neni 6.1 i KEDNJ i vë gjykatat nën detyrim për të dhënë arsye për vendimet që marrin. Në veçanti gjykatat e shkallëve më të ulëta apo autoritete tjera vendimmarrëse duhet të japin arsye të bazuara për të mundësuar palët që

të përdorin në mënyrë efektive cilëndo nga të drejtat ekzistuese të apelit (H. kundër Belgjikës (1987) Duke prezumuar se kjo kërkesë është përmbushur, një gjykatë e apelit në parim, thjesht mund të mbështesë arsyet për vendimet e dhënë nga gjykata e shkallës më të ulët (Garcia Ruiz kundër Spanjës (1999) dhe Helle kundër Finlandës (1997).

Gjykata Supreme konstaton se pretendimet tjera janë paraqitur edhe në ankesat kundër aktgjyimit të shkallës së parë dhe kryesisht janë përsëritur në kërkesat për mbrojtjen e ligshmërisë. Për këto pretendime janë dhënë arsye në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.456/15 të datës 14.09.2016 dhe në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml.Kzz.nr.322/2016 të datës 19.07.2017.

Gjykata Supreme gjeti se këto arsye janë të detajuara, bindëse dhe ligjore dhe se është përmbushur në mënyrë efektive e drejta ligjore për apelimin e vendimit. Andaj, këto arsye u mbështetën me aktgjykimin e marrur tani, në procedurën e rivendosjes.

Nga këto arsye, kërkesat për mbrojtjen e ligshmërisë ishin të pabazuara dhe konform nenit 437 të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pml.nr.158/2018, më 26.09.2018

Procesmbajtësja,
Minire Xhambazi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka